




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Received Prenjuro / Prescribed Received / Delivery		viti god year	
26 . 11 2018		8	
Organ / Niveli Organi / Jedinita Org. / Unit	Pr. / Prot. Prot. No.	Shënimi Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	7154/2018		111



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 301 /2018
Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Mitrovicës së Jugut, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
2. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Mitrovicës së Jugut, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:


- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Menaxherit të Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe
- Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorëzuar Primjena / Predato Received / Delivered		26 - 11 2018 viti god year	
Organ./Jedinstvo Org./Unit	Nr. Prot. Sr. Prot. Prot.No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMShCK	7154/2018		1113

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

KOMUNËN E MITROVICËS SË JUGUT

PER

VITIN 2017

Prishtinë, 2018

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Funksioni i Mbikëqyrjes.....	3
Objektiva dhe metodologjia e mbikëqyrjes.....	3
Fushat e mbikëqyrjes.....	4
Raporti për mbikëqyrjen në Komunën e Mitrovicës së Jugut.....	5
Organizimi i Brendshëm dhe të Dhënat e të Punësuarve.....	6
Procedurat e Rekrutimit dhe të Avancimit.....	7
Procedurat Disiplinore.....	8
Procedurat e Ankesave.....	8
Procedurat e Vlerësimit.....	9
Procedurat e Pushimeve.....	10
Procedurat e Transferimit.....	10
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta.....	10
Pezullimi, Ndërprerja dhe Përfundimi i Marrëdhënies së Punës.....	11
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik..	12
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	12
Trajnimi i Nëpunësve Civil.....	12
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....	12
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....	13
Shënimet/komentet/konkluzionet e përgjithshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	13

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar "Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil", mbi bazën e të cilit edhe harton "Planin e Mbikëqyrjes" në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësi për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementim të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË KOMUNËN E MITROVICËS SË JUGUT

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Komunën e Mitrovicës së Jugut për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Komuna e Mitrovicës së Jugut përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Komunën e Mitrovicës së Jugut me datë 24.10.2018, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Vendimi i datës 14.02.2017 për pezullimin e procedurës administrative;
- Vendimin me Nr. 05-31-34733 të datës 19.06.2012 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Shef i Sektorit për Transport Rrugor";
- Vendimin me Nr. 05-31-121755 të datës 16.05.2013 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Shef i Sektorit të Ndërtimit";
- Vendimin me Nr. 01-112/01-0026138-2/17 të datës 05.04.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Drejtor i Qendrës Kryesore të Qendrës Familjare";
- Vendimin me Nr. 01-112/03-0041685 të datës 30.05.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Drejtor i Bibliotekës";
- Vendimin me Nr. 01-112/01-0094667/17 të datës 12.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën "Udhëheqës i Personelit";
- Vendimi për dorëheqjen nga pozita të "Udhëheqës i Personelit";
- Akt emërimi i datës 20.08.2012 për pozitën "Shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim";
- Akt emërimi i datës 06.05.2014 për pozitën "Shef i Sektorit të Zhvillimit Ekonomik";
- Akt emërimi i datës 14.03.2016 për pozitën "Udhëheqës i Njesisë së Komunikimit Publik";
- Akt emërimi i datës 25.02.2013 për pozitën "Zyrtar i Shërbimeve Sociale";
- Formular për vlerësimin e rezultateve në punë për pozitën "Zyrtar i Shërbimeve Sociale";
- Vendimi i datës 01.12.2016 për Themelimin e Komisionit Disiplinor;
- Vendimi i datës 15.12.2016 për plotësim ndryshimin e vendimit për Themelimin e Komisionit Disiplinor;
- Vendimi i datës 18.08.2012 për themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
- Vendimi i datës 18.10.2018 për plotësim ndryshimin e vendimit për themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
- Vendimi i datës 14.09.2017 për plotësim ndryshimin e vendimit për themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
- Vendimi i datës 02.10.2017 për plotësim ndryshimin e vendimit për themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
- Vendimi i datës 29.09.2017 për plotësim ndryshimin e vendimit për themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
- Email Zyrtar i datës 02.10.2017;
- Vendimi për lejimin e pushimit të lehonisë i datës 05.06.2017;

- Vendimi për lejin e pushimit të lehonisë i datës 30.06.2017;
- Vendimi për lejin e pushimit të lehonisë i datës 05.06.2017;
- Vendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës i datës 01.12.2017;
- Vendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës i datës 05.04.2017;
- Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës i datës 02.08.2017;
- Vendimi për pushim pa pagesë i datës 19.09.2017;
- Vendimi për pushim pa pagesë i datës 11.08.2017;
- Kërkesa për transferim të përhershëm e datës 05.10.2017;
- Procesverbali mbi dorëzimin e dosjes me rastin e transferimit i datës 20.10.2017;
- Marrëveshja për transferimin e përhershëm e datës 10.10.2017;
- Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 06.09.2017;
- Formular i planit individual të personelit i datës 31.10.2016;
- Plani vjetor i trajnimit të nëpunësve civil i datës 03.02.2017;
- Listën e personave të angazhuar me kontratë për marrëveshje për shërbime të veçanta dhe të gjitha marrëveshjet për shërbime të veçanta për vitin 2017

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në "pyetësor", ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Komunën e Mitrovicës së Jugut më datë 24.10.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren Nr. 01/2017 për Plotësim të Rregullores Komunale Nr. 02/2012 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësit e Organeve të Administratës Komunale e cila është duke u zbatuar, është përfunduar edhe klasifikimi i vendeve të punës. Në këtë institucion janë të punësuar 348 nëpunës civil, ndërsa të lira kanë pasur 27 pozita.

Gjatë vizitës Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar dosjet e personelit dhe ka konstatuar se janë shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil ndërsa si kopje janë marrë tri (3) dosje atë për pozitën "Shef i Zyrës Komunale për Komunitet dhe Kthim", "Udhëheqës i Sektorit të Zhvillimit Ekonomik" dhe "Zyrtar për Shërbime Sociale" dhe në bazë të shqyrtimit të dosjeve është konstatuar që dosjet e personelit kanë qenë të kompletuara ashtu siç përcaktohet me dispozitat e dispozitat e Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendrorë të Nëpunësve Civilë.

Ushtruesit e detyrës: Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion ka pasur pesë (5) pozita me ushtrues detyre (Udhëheqës i Personelit, Shef i Sektorit për Transport Rrugor, Shef i Sektorit të Ndërtimit, Drejtor i Bibliotekës dhe Drejtor i QKMF-së.

Kolegji gjatë shqyrtimit të dosjeve ka konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr. 05-31-34733 të datës 19.06.2012 për caktimin

ushtruesit të detyrës për pozitën “Shef i Sektorit për Transport Rrugor”, Vendimit me Nr. 05-31-12175 të datës 16.05.2013 për caktim të ushtruesit të detyrës në pozitën “Shef i Sektorit të Ndërtimit”, Vendimit me Nr.01-112/01-002613802/17 të datës 05.04.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën “Drejtor i QKMF-së”, Vendimit me Nr. 01-112/03-0041685 të datës 30.05.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën “Drejtor i Bibliotekës” dhe Vendimit me Nr. 01-112/01-009467/17 të datës 12.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën “Udhëheqës i Personelit”, ka konstatuar se të gjitha këto pozita me ushtrues detyrë kanë qenë për një periudhë më shumë se tre muaj, andaj konstaton se Komuna e Mitrovicës së Jugut ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse pozitat me ushtrues detyrë nuk mund të mbahen me gjatë se tre (3) muaj.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes, dhe se ne rastin e caktimit të ushtruesve të detyrës ta respektoj nenin 30 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut ka përgatitur planin e personelit dhe gjatë vitit 2017 ka zhvilluar pesë (5) procedura të rekrutimit/avancimit, ku prej tyre dy janë anuluar nga Këshilli. Po ashtu në këtë institucion janë lidhur tridhjetë e tri (33) kontrata me marrëveshje për shërbime të veçanta të cilat janë zhvilluar pa procedura të thjeshtësuara të rekrutimit, ndërsa nëntë (9) nga këto marrëveshje janë lidhur për pozita të shërbimit civil. Pas analizimit janë konstatuar këto të gjetura:

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të të punësuarve me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të veçanta, ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut për vitin 2017 ka pasur të angazhuar tridhjetë e tri (33) të punësuar me marrëveshje për shërbime të veçanta, ku nuk ka zhvilluar asnjë procedurë të rekrutimit, ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, që me rastin e lidhjes së kontratave me marrëveshjeve për shërbime të veçanta, të veproj në pajtim me dispozitat e nenit 12 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 18 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil pasi që duhet zhvilluar një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

E GJETURA 2: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të punësuarve me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të veçanta, ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut prej 33 marrëveshjeve për shërbime të veçanta nëntë (9) prej të tyre janë angazhuar në pozitat e nëpunësve civil.

Kolegji ka konstatuar që në bazë të nenit 12 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ekzistojnë dy kategori të të punësuarve: „*pozitat e nëpunësve civilë të karrierës dhe pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës*”.

Në kuptim të kësaj dispozite, pozitat e nëpunësve civil të karrierës apo të jo karrierës, nuk mund të plotësohen me nëpunës me kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, që me rastin e lidhjes së Kontratave me marrëveshjeve për shërbime të veçanta duhet pasur parasysh që të njëjtat nuk mund të lidhen marrëveshje të tilla por duhet ndjekur procedurat e parapara me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut në bazë të Vendimit me numër 01Nr. 031/88016 të datës 01.12.2016 ka të themeluar Komisionin Disiplinor i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar që është në pajtim me nenin 70 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Në bazë të vlerësimeve të dosjeve në këtë institucion është zhvilluar një procedurë disiplinore për të punësuar që nuk janë shërbyes civil dhe komisioni ka nxjerr vendim. Lidhur me këtë rast kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit të datës 14.02.2017 të Komisionit Disiplinor për vendosje të rasti për të punësuarin “Roje Pylli”, ka konstatuar që Komisioni Disiplinor i themeluar në bazë të legjislacionit për shërbimin civil nuk mund të shqyrtoj rastet e inicimit të procedurës disiplinore për punëtorët që nuk kanë statusin e shërbyesit civil, sepse komisioni disiplinor i themeluar në bazë të legjislacionit për shërbimin civil trajton rastet që kanë të bëjnë me nëpunësit civil siç përcaktohet me nenin 70 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 2 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinor në Shërbimin Civil, andaj në rastet kur kemi inicim të procedurës disiplinor ndaj të punësuarve që nuk kanë statusin e nëpunësit civil mund themelohet një komision tjetër disiplinor i cili trajton rastet e tilla, e anëtarët mund të jenë edhe nëpunës civil.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Komisionit Disiplinor të Komunës së Mitrovicës së Jugut, që në rastet kur bëhet inicimi i ndonjë procedurë disiplinore ndaj nëpunësve që nuk kanë statusin e shërbyesit civil të bëhet themelimi i një Komisioni Disiplinor për rastet e tilla në pajtim me Ligjin e Punës dhe akteve tjera sepse Komisioni Disiplinor i themeluar në bazë të legjislacionit për shërbimin civil nuk ka kompetencë të shqyrtoj rastet ndaj këtyre nëpunësve.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut në bazë të Vendimit me numër protokolli 01-030/01-0055518/17 të datës 18.07.2017 ka të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e

Kontesteve dhe Ankesave i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar. Në bazë të vlerësimeve të dosjeve në këtë komision gjatë vitit 2017 janë parashtruar 10 ankesa dhe për të cilat është vendosur. Lidhur me këtë rast kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me numër protokoli 01-030/01-0055518/17 të datës 18.07.2017 ka të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, respektivisht vendimit 14.09.2017, 29.09.2017 dhe 02.10.2017 me të cilët është bërë ndryshim/plotësimi i pikës së parë të Vendimit me numër protokoli 01-030/01-0055518/17 të datës 18.07.2017, ka konstatuar që në vendime nuk është dhënë arsyetimi se cilat kanë qenë arsyet e ndryshimit edhe pse gjatë vizitës na është thënë që ndryshimi ka ndodh për shkak që disa anëtar të komisionit kanë shprehur se kanë konflikt interesi për shqyrtimin e ankesave, mirëpo Kolegji vlerëson që në çdo ndryshim apo plotësim të vendimit duhet dhënë arsyetim i saktë për arsyet e ndryshimit sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi që anëtarët e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave kanë mandat dy vjeçar.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, që në rastet kur bëhet ndryshim/plotësimi i vendimit për themelim të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të jepet arsyetim i saktë se cilat kanë qenë arsyet e ndryshimit apo plotësimin siç e përcakton dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut, nuk ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civil, sepse për 38 nëpunës civil nuk është bërë vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2017. Në vitin 2017 për 2 nëpunësi civil ka qenë dashur të vlerësohen me rastin e kryerjes së periudhes provuese (Udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun dhe Drejtor i Qendrës së Kulturës) por nuk është bërë, në këtë rast lidhur me këtë fushë kemi konstatuar këto të gjetura:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se për disa nëpunës civil nuk është bërë vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2017 edhe pse Zyra e Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut më datë 02.11.2017 ka përcjell shkresë për drejtorët e drejtorive dhe udhëheqësit e drejtpërdrejtë të nëpunësve civil, që vlerësimi i rezultateve të punës duhet të bëhet deri brenda afateve ligjore, në këtë rast mos vlerësimi i rezultateve të punës për të gjithë nëpunësit civil është shkelje e dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe me dispozitat nenit 3 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë, sepse moskryerja e vlerësimit mund të përbëjë shkak për fillimin e procedurës për masë disiplinore sipas nenit 33 paragrafit 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Udhëheqësit e Drejtpërdrejt të nëpunësve civil që vlerësimi i rezultateve të punës duhet të

bëhet për të gjithë nëpunësit pasi që është obligim ligjor ashtu siç parashihet me nenin 33 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 3 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civilë.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se për dy (2) nëpunës civil nuk është kryer vlerësimi i periudhës provuese ne afate e caktuara, respektivisht nëpunësit civil për pozitën “Udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun” Akt Emërimi i është lëshuar më datë 14.03.2016 dhe në bazë të dosjes të njëjtin nuk i është bërë vlerësimi i periudhës provuese ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 3, 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, që të ndërmerr masat që në të ardhmen për të gjithë nëpunësit civil që janë në periudhë provuese e njëjta t’i bëhet duke u respektuar procedurat dhe afatet sipas Rregullores Nr. 02/2011 për Punën Provuese të Nëpunësve Civilë.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban në kopje fizike dhe elektronike, 63 nëpunës kanë realizuar pushimin mjekësor dhe në dosje kanë qenë të vendosura shenjat mjekësore, tetë (8) nëpunës civil kanë realizuar pushimin pa pagesë dhe në bazë të shqyrtimit të dosjes ka qenë kërkesa për pushim si dhe vendimi po ashtu pesë (5) nëpunës civil kanë realizuar pushimin lehonisë dhe në bazë të shqyrtimit të dosjeve kanë qenë të vendosura vendimet, në këtë rast tek procedurat e pushimeve janë respektuar dispozitat e Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut, gjatë vitit 2017 ka pasur një (1) transferim të përhershëm i cili ka qenë i jashtëm në bazë të të cilit është bërë marrëveshja mes Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Komunës së Prishtinës, dhe në këtë kuptim janë respektuar të gjitha procedurat e përcaktuara me Rregulloren Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut, ka të punësuar 348 nëpunës civil prej tyre 334 janë shqiptar, 2 serb, 8 boshnjak dhe 4 turq, prej 348 të punësuar nëpunës civil 146 janë të punësuar femra ndërsa 202 janë meshkuj ndërsa në këtë komunë nuk kas asnjë nëpunës

civil të punësuar nga persona me aftësi të kufizuara. Në bazë të vlerësimit të të dhënave kemi konstatuar këto të gjetura:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 348 nëpunësve civil të punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, 146 prej tyre janë femra ndërsa 202 janë meshkuj, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 3483 nëpunësve civil të punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, asnjë prej tyre nuk është i punësuar nga personat me aftësi të kufizuara, me çka nënkuptohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, pasi që për çdo 50 të punësuar në shërbim civil një duhet me qenë person me nevoja të veçanta.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara pasi që çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Mitrovicës së Jugut, asnjë nëpunës nuk pezulluar marrëdhënien e punës në shërbimin civil (pezullim i dakorduar). Në bazë të vlerësimit të dosjeve pesë nëpunës civil kanë realizuar pushim pa pagesë, asnjë nëpunës civil nuk është në pezullim me 50% të pagesë (pezullim parandalues), ndërsa një (1) nëpunës civil ju ka ndërprerë marrëdhënien e punës pasi ka dhënë dorëheqje dhe në këtë rast janë respektuar procedurat ligjore. Po në bazë të vlerësimit të dosjeve është konstatuar që pesë (5) nëpunësve civil i është përfunduar marrëdhënien e punës për shkak të arritjes së pensionimit të cilëve i është bërë pagesa e një page të njëhershme në pajtim me legjislacionin në fuqi, po ashtu asnjë nëpunësi civil nuk i është përfunduar marrëdhënien e punës për shkak (ushtrimit të detyrave për arsye shëndetësore, përfundimit të afatit për punë me afat të caktuar) një nëpunësi civil i është përfunduar marrëdhënien e punës pasi që është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për mbajtje të burgut efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër, ndërsa një nëpunësi civil i është përfunduar marrëdhënien e punës për shkak të vdekjes ndërsa familjes së ngushtë nuk i është bërë pagese një page sipas legjislacionit në fuqi dhe në këtë kuptim kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr. 01-118/02-0092076/17 të datës 01.12.2017 për përfundimin e marrëdhënies së punës të nëpunësit civil me vdekje, ka konstatuar që familjes së ngushtë të nëpunësit civil (bashkëshortes) nuk i është bërë pagesa e një page të

njëhershme në vlerën e një page mujore edhe pse Zyra e Personelit më datë 01.12.2017 ka përcjell tek Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik kërkesën për ndryshim të listës së pagave, andaj Kolegji vlerëson se mos pagesa e një page për familjen me rastin e vdekjes së nëpunësit civil është në kundërshtim me nenin 22 paragrafin 2 nënparagrafin 2.4 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenin 22 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, që të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për eliminimin e shkeljes dhe për të gjithë nëpunësit civil të cilëve i përfundon marrëdhënia e punës me vdekje të bëhet pagesa një page për familjen e nëpunësit civil ashtu siç përcaktohet me nenin 22 paragrafin 2 nënparagrafin 2.4 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenin 22 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Mitrovicës së Jugut nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mbanë pozitë të nëpunësit civil dhe ndonjë post publik.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Mitrovicës së Jugut, ndaj asnjë nëpunësi civil nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut, respektivisht Zyra e Personelit, ka përgatitur planin e trajnimeve në të cilin përfshihen edhe trajnimet, por dhe të cilat trajnime janë marrë parasysht nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe 100 nëpunës civil kanë ndjekur trajnimet, ndërsa nuk ka asnjë nëpunës që ka ndjekur trajnimet me pagesë.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHTESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut, vijimin në punë e mban në formë elektronike. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohet në pajtim me akt emërimet ndërsa përveç IT-së asnjë nëpunës në bazë të listës së pagave nuk ka gëzuar ndonjë shtesë.

Kolegji për këtë fushë të mbikëqyrjes nuk ka gjetur shkelje, andaj nuk janë dhënë rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut, gjatë vitit 2017 ka pranuar 17 vendime të Këshillit, prej tyre shtatë ka qenë e obliguar ti zbatoj, te cilat i ka zbatuar ne tërsi.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut në vitin 2017 është monitoruar për vitin 2016 dhe i janë dhënë tetë (8) rekomandime, ku nga to vetëm një e ka adresuar, ndërsa të tjerat nuk i ka adresuar.

Rekomandim 1: Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të Këshillit ashtu siç përcaktohet me nenin 21 të Ligj Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

15. SHËNIMET/KOMENTET PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes, ka konstatuar njembëdhjetë (11) të gjetura dhe ka dhënë njembëdhjetë (11) rekomandime,.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Komunës së Mitrovicës së Jugut, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

I dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Menaxherit të Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Arkivit të KPMSHCK.

Hajzer Salihu
Kryetar i Kolegjit



Sabile Avdyli
ZL për Bashkëpunim Profesional